

Plagoset me armë zjarri një person në Podujevë



Foto: Ilustrim/KOHA

Një person në Podujevë është plagosur me armë zjarri në orët e hershme të së shtunës.

Policia e Kosovës, në raportin e saj 24-orësh, ka njoftuar se viktima ishte dërguar në QKUK në Prishtinë, ndërsa kishte plagë nga arma e zjarrit. Dy persona dyshohen për plagosjen e tij, ndërsa ata gjenden në arrati. Rasti është cilësuar “vrasje në tentativë”. Në vendin e ngjarjes janë gjetur një pistoletë me pesë fishekë, dy gëzhjoja dhe 7.1 gramë marihuanë.

“Podujevë 03.06.2023 - 00:53 - Viktima mashkull kosovar, është dërguar në QKUK për tretman mjekësor, pasi që është plagosur me armë zjarri nga dy të dyshuar meshkuj kosovar. Në vendin e ngjarjes është konfiskuar një pistoletë me pesë fishekë, dy gëzhjoja dhe rreth 7.1 gramë substancë narkotike e llojit marihuanë. Të dyshuarit gjenden në arrati. Rasti është duke u hetuar”, thuhet në raportin e Policisë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#PLAGOSJE

#PODUJEVË

#POLICIA E KOSOVES

4 qershor 2023, 09:55

Shpërndaje në



Taboola Feed

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave

Blog | Sponsored

Lexo më shumë

Jeni lodhur duke mbajtur shumë gota? Zgjidhni Power Zoom

POWER ZOOM | Sponsored

Kurti merr telefonatë nga administrata Biden

Kryeministri Albin Kurti ka përsëritur se bandat e sponsorizuara nga Beogradi duhet ta ndalojnë menjëherë dhunën në veri të Kosovës. Ai ka biseduar me zëvendëskëshilltarin pë...

Kohanet

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored

Lexo më shumë

TË TJERA

Dyshohet se keqtrajtoi e rrahu fëmijën e saj, arrestohet

Gruaja i raporton si të zhdukur dy fëmijët e saj në Ferizaj

Rrihet më fqinjët e policin, arrestohet burri në Fushë-Kosovë

Policia kërkon ndihmë për gjetjen e një personi të njohur si “Gishti”

